



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I 97-10 Prot.
Nr. Dok. 202503629/10

Tiranë 17.12.2025

Lënda: *Marrjen e masave të menjëhershme për vlerësimin e mundësive për ofrimin e ndihmës sociale dhe mbështetjes për familjen B., për të përfituar nga programet sociale të strehimit që zbatohen nga Bashkia Fier.*

BASHKISË FIER

Të nderuar,

Avokati i Popullit si një institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Në përmbushje të misionit kushtetues, si garant i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nxitës i standardeve më të larta të këtyre të drejtave, institucioni i Avokatit të Popullit i kushton një vëmendje të posaçme grupeve në nevojë dhe ndjek me prioritet mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të tyre.

Siç jeni në dijeni nga komunikimet e mëparshme institucionale, institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13, të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nisur nga lajmi i publikuar

në median online me titull: “ Ndhimë për qytetaren nga Fieri, në kushte të mjerueshme jetese”¹, ka filluar me nismën e tij, ndjekjen e kësaj çështjeje.

Në lajm mësuam se znj. Sh. B., 57 vjeçe, banon në fshatin Kallëm i Vogël, Fier, në kushte tejet të vështira jetese dhe varfëri. Shtëpia ku banon është gati të shembet, pa dyer e dritare, dhe çdo ditë përballen me të ftohtin, lagështinë dhe mungesën e kushteve minimale për të jetuar. Në familje jeton edhe një foshnjë 8-muajshe. Familja ka nevojë urgjente për ndihmë dhe mbështetje sociale.

Në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, Avokati i Popullit, pasi është njohur me problematikën e sipërcituar, vendosi marrjen në shqyrtim të saj dhe nisjen e hetimit administrativ, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” të ndryshuar².

Në kuadër të hetimit administrativ, të orientuar për gjetjen e një zgjidhjeje të drejtë e të qëndrueshme të rastit, me qëllim vlerësimin dhe trajtimin e mundshëm të kësaj problematike, Avokati i Popullit, në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor³ i ka kërkuar Bashkisë Fier dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Fier, informacion dhe shpjegime, lidhur me situatën social ekonomike të kësaj familjeje, në përbërje të së cilës ka dhe fëmijë të mitur, dhe mundësitë për ta ndihmuar atë në adresimin e problematikës së evidentuar.

Në përgjigje të shkresës nr. K1/I97-3 Prot, datë 14.10.2025 “Kërkesë për shpjegime”, DRSHSSH Fier na informon se:

Drejtorja Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier na informon se, pas verifikimit në terren të kryer më datë 27.10.2025 nga administratorja sociale e Njesisë Administrative Mbrostar Ura, është konstatuar se familja e znj. Sh. B. jeton në kushte mjaft të vështira ekonomike. Në certifikatën familjare rezulton znj. Sh. B. si kryefamiljare dhe djali i saj, F. B., 22 vjeç, ndërsa kryefamiljari ka ndërruar jetë më 26.03.2025. Nga bashkëjetesa e F.it me një shtetase të mitur, ka lindur një fëmijë 8 muajsh, i cili nuk rezulton në certifikatën familjare për shkak të mungesës së celebrimit, me atësi të njohur dhe e regjistruar pranë vendbanimit të nënës, në Shushicë, Elbasan. Banesa e familjes, në pronësi të kryefamiljarit të ndjerë, është objekt i vjetër me dëmtime të konsiderueshme strukturore (mure të çarë dhe çati të

¹ https://www.facebook.com/reel/1366587254982369?locale=it_IT

² Neni 13, paragrafi i pare: “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”.

³ Neni 63, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet: “Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”, si dhe neni 19 pika b, Ligji Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”.

amortizuar) dhe mungesë të theksuar të kushteve higjieno-sanitare, në kushte të pabanueshme. Aktualisht, asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune, ndërsa F.i është i paaftë për kohësisht për punë për shkak të një aksidenti. Familja nuk zotëron tokë apo mjete jetese. Rasti është referuar për regjistrim si punëkërkues i papunë, për shpalljen e martesës ose bashkëjetesës pranë gjendjes civile dhe për aplikim për ndihmë ekonomike, ndërkohë që Njësia Administrative Mbrostar Ura i është drejtuar Bashkisë Fier me shkresë zyrtare ku kërkon ndërhyrjen e nevojshme për riparimin e banesës duke theksuar dëmtimet e dukshme në strukturë. Gjithashtu rasti do të vijojë të menaxhohet nga shërbimet sociale përkatëse. (Informacioni është shoqëruar me fotot përkatëse të banesës).

Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit, me anë të disa shkresave të përsëritura zyrtare⁴, në vijimësi i ka kërkuar Bashkisë Fier, informacion mbi trajtimin e mundshëm të problematikës si dhe të masave që janë marrë, apo janë parashikuar të ndërmerren, për zgjidhjen e kësaj situate shqetësuese, por Bashkia Fier nuk ka kthyer përgjigje.

Konsiderata të Avokatit të Popullit.

Për të përmirësuar kushtet e jetesës së qytetarëve, anëtarë të grupeve në nevojë, lidhur me kushtet e tyre të vështira të jetesës, strehimin e varfërinë dhe për të siguruar që ata të jetojnë në përputhje me standardet e pjesës tjetër të popullsisë në vendin tonë, është e nevojshme të përmbushen detyrimet që rrjedhin nga angazhimet ndërkombëtare dhe nga kuadri i brendshëm ligjor. Mungesa e kushteve minimale të jetesës së këtyre qytetarëve është një problem serioz që krijon premisat që anëtarë të këtyre grupeve të ndihen të diskriminuar, të pabarbartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen. Për të mundur përmirësimin e kushteve të jetesës për këto grupe të marginalizuara nevojitet kuptim, dedikim dhe koordinim ndër-institucional, i cili ka një rëndësi thelbësore për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të këtyre qytetarëve.

E drejta për strehim është një prej të drejtave themelore të rëndësishme të njeriut, që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për jetën dhe shëndetin dhe si e tillë përfshihet në një numër të konsiderueshëm të instrumentave të së drejtës ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në nenin 25.1, përcakton se: *“Çdokush ka të drejtën e një standardi jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin.”* Ky formulim thekson se strehimi është një element i domosdoshëm për të garantuar dinjitetin dhe mirëqenien e individit dhe

⁴ Shkresa nr K1/I97-2 prot., datë 14.10.25, Bashkisë Fier, me lëndë: “Kërkesë për shpjegime”.; Shkresa nr K1/I97-5 prot., datë 04.11.25, Bashkisë Fier, me lëndë: “Kërkesë e përsëritur për shpjegime”. Shkresa nr K1/I97-8 prot., datë 13.11.25, Bashkisë Fier, me lëndë: “Kërkesë e përsëritur për shpjegime”.

familjes. Në të njëjtën linjë, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është pjesë të rendit juridik të brendshëm të Shqipërisë nëpërmjet jurisprudencës së pasur të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e njeh të drejtën për strehim si një të drejtë themelore, duke e lidhur ngushtësisht me të drejtën për jetën private dhe familjare, sigurinë dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor. Po kështu, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore u ngarkon shteteve palë detyrimin për të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim realizimin progresiv të së drejtës për strehim të përshtatshëm, duke garantuar jo vetëm një hapësirë fizike për banim, por edhe kushte të sigurta, të përballueshme dhe të qëndrueshme jetese. Gjithashtu, Karta Sociale Evropiane dhe Karta Sociale Evropiane e Rishikuar, theksojnë të drejtën për mbrojtje sociale dhe të drejtën e drejtpërdrejtë për strehim. Neni 16 i Kartës “E drejta e mbrojtjes sociale, ligjore dhe ekonomike e familjes”, cilëson: Me qëllim që të sigurojnë kushtet e nevojshme për zhvillimin e plotë të familjes, e cila është bërthama themelore e shoqërisë, Palët Kontraktuese marrin përsipër të nxisin mbrojtjen e jetës familjare ekonomike dhe sociale me anë të mjeteve të tilla si përfitimet sociale dhe familjare, marrëveshjet fiskale, ofrimin e strehimit familjar, përfitime për të sapo martuarit dhe mjete të tjera të përshtatshme. Neni 31 i Kartës Sociale Evropiane parashikon: “Të drejtën e strehimit”. Me qëllim që të garantojë zbatim efektiv të së drejtës për strehim, palët marrin përsipër masa të cilat: (i) nxisin aksesin tek strehimi i një standardi të përshtatshëm; (ii) nxisin dhe zvogëlojnë mosstrehimin me qëllim eliminimin e plotë të tij; (iii) ofrimin e çmimeve të shtëpive që janë të përballueshme për ata që nuk kanë mjetet e përshtatshme”.

Sipas këtyre instrumentave ndërkombëtarë, shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore për strehim dhe të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Sa më sipër, duhen pasur në konsideratë edhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ) për zbatimin e të cilave institucioni i Avokatit të Popullit kontribuon duke orientuar institucionet t’i qëndrojnë pranë qytetarëve më në nevojë, për të mos i rrezikuar ofrimin e shërbimeve adekuate dhe të qëndrueshme për ta. Një nga objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm është siguri i të gjithë qytetarëve, me prioritet shtresat në nevojë, për të patur të drejta të barabarta dhe qasje në shërbimet themelore. Deri në vitin 2030 duhet siguruar qasja në strehim të përshtatshëm, të përballueshëm dhe të arritshëm për të gjithë. Zbatimi i Agjendës 2030 “Për Zhvillimin e Qëndrueshëm”⁵ është thelbësor, për sigurimin e mirëqënies dhe gëzimit të të gjithë të drejtave për qytetarët. Angazhimi kryesor që “Asnjë të mos mbetet pas” përbën parimin kyç të të gjitha Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

⁵ Kombet e Bashkuara (2015). Të transformojmë botën tonë: Axtenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030. Marrë nga <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication>, e aksesueshme në dhjetor 2015.

E drejta për strehim në Republikën e Shqipërisë është e garantuar nga Kushtetuta. Neni 59, pika 1, gërma “b” e Kushtetutës e përfshin strehimin ndër objektivat sociale të shtetit, duke përcaktuar se: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim.” Kjo dispozitë pasqyron angazhimin e shtetit për të promovuar kushte të përshtatshme jetese që sigurojnë integritetin dhe dinjitetin njerëzor dhe për të garantuar mbështetje institucionale të drejtë e të barabartë për qytetarët. Megjithëse objektivat sociale të nenit 59 nuk përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta të zbatueshme, ato kanë një rol thelbësor orientues. Kushtetuta përcakton se shteti, brenda mjeteve që ka në dispozicion dhe në plotësim të nismës e përgjegjësisë private, synon realizimin e këtyre objektiveve. Për rrjedhojë, ato udhëheqin politikë-bërjen dhe procesin legjislativ, duke i vendosur organeve publike përgjegjësi të qarta për zhvillimin e politikave sociale dhe për mbrojtjen e personave në nevojë. Në këtë kuadër, pika “b” e nenit 59 artikulon qartë synimin për të adresuar dhe plotësuar nevojat e shtetasve për strehim, si pjesë integrale e politikave sociale të shtetit.

Gjithashtu, ligji themeltar i vendit tonë, përcakton Institucionin e Avokatit të Popullit (neni 60) si garant i mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, sidomos të shtresave në nevojë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve publike.

Më tej, vlen të theksohet se ligjvënësi ka parashikuar një sërë mekanizmesh ligjorë dhe instrumentesh procedurale në funksion të njësive të vetëqeverisjes vendore, me qëllim që këto të fundit të jenë në gjendje të ofrojnë mbështetje konkrete dhe efektive për shtresat e popullsisë që ndodhen në kushte të vështira socio-ekonomike. Legjislacioni në fushën e shërbimeve sociale synon në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë garantimin e një mbështetjeje të qëndrueshme për qytetarët dhe familjet që përballen me vështirësi ekonomike apo sociale. Në veçanti, për individët dhe familjet që ndodhen në situata të cënueshme, përfshirja aktive dhe bashkërendimi ndërinstitutional përbëjnë elementë kyç për realizimin efektiv të politikave të mbrojtjes sociale. Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave të çdo rasti duhet të bëhet në mënyrë të personalizuar, gjithëpërfshirëse dhe me ndjeshmëri të lartë sociale, në përputhje me standardet ligjore dhe etike që rregullojnë këtë fushë. Kjo qasje jo vetëm që synon trajtimin me dinjitet të individëve në nevojë, por forcon gjithashtu rolin e institucioneve vendore si garantë të mbështetjes sociale në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës dhe barazisë para ligjit.

Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”⁶ i përditësuar, dhe aktet nënligjore, përfaqësojnë një kapërcim të qënësishëm cilësor në mënyrën si perceptohet strehimi i përballueshëm, si adresohen grupet në nevojë, dhe si hartohen programet e veçanta

⁶ ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023;

të strehimit. Ky ligj parashikon parimet për strehim të përshtatshëm⁷, duke përcaktuar edhe kriteret që e klasifikojnë strehimin e përshtatshëm⁸, llojet e programeve të strehimit, ndërthurjen e tyre me shërbimet sociale, rolin e njësive të vetqeverisjes vendore dhe qendrore dhe kriteret për përfitim nga këto programe nga qytetarët në nevojë⁹. Bashkitë, si njësi të vetqeverisjes vendore, vendosen në një rol proaktiv dhe qendror, në ofrimin e strehimit social, duke qenë përgjegjëse për identifikimin dhe hartëzimin e grupeve të qytetarëve në nevojë, si dhe për përcaktimin e formave dhe mekanizmave të financimit të programeve të strehimit¹⁰. Ky rol merr një rëndësi të veçantë për garantimin e një jete të përshtatshme, të sigurt dhe dinjitoze për çdo individ dhe familje që ndodhet në kushte të vështira ekonomike e sociale. Për adresimin efektiv të problematikave të konstatuara dhe për përmirësimin e qasjes së qytetarëve në këto programe, organet e pushtetit vendor, në cilësinë e institucioneve përgjegjëse më afër komunitetit, duhet të ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje me standardet më të larta të qeverisjes lokale, duke respektuar parimin e subsidiaritetit. Ky parim kërkon që vendimmarrja dhe ofrimi i shërbimeve të bëhet në nivelin më afër qytetarit, me qëllim që nevojat të adresohen sa më drejtëpërdrejt dhe efektivisht. Referuar dispozitave të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, e konkretisht neni 3 i të cilit përcakton: “Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve¹¹, është në misionin e organeve të qeverisjes vendore e kryesisht të bashkive, që të sigurojnë qeverisje të efektshme, efikase dhe sa më pranë komuniteteve, në mënyrë që t’u krijojnë atyre mundësitë në lidhje me ofrimin e mbështetjes sociale¹² për një jetë të përshtatshme e dinjitoze. Bashkitë duhet të sigurojnë mekanizmat ligjorë e financiarë për nxjerrjen e tyre nga mjerimi¹³.

Sa më sipër, bashkitë duhet të garantojnë jo vetëm reagimin ndaj ankesave individuale të qytetarëve, por edhe adresimin në mënyrë gjithëpërfshirëse të situatës së përgjithshme të strehimit social në territorin e tyre. Kjo nënkupton ofrimin e

⁷ Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social” i ndryshuar, nenet 3-10

⁸ Po aty, neni 4 “Parimet e strehimit të përshtatshëm”;

⁹ Po aty, nenet 11, 12, 13;

¹⁰ Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, neni 18, neni 69, pika 2, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi nr. 31, datë 18.11.2018 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, i Ministrit të Financave;

¹¹ Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 3 përcakton: “Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet: a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive; b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative”.

¹² Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligji Nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar; Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”

¹³ Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Kreu III, neni 8, 9; Kreu VII, nenet 21,21,23,24; Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, neni 18, neni 69, pika 2.

garancive të nevojshme social-ekonomike për qytetarët dhe grupet vulnerabël, duke siguruar respektimin e të drejtave themelore të njeriut, me theks të veçantë mbi të drejtën për strehim.

Lidhur me rastin konkret në trajtim, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se parimet dhe detyrimet që burojnë nga Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, si dhe nga legjislacioni shoqëruar për vetëqeverisjen vendore dhe shërbimet e kujdesit shoqëror, vendosin një përgjegjësi të qartë për bashkitë në garantimin e të drejtës për strehim të përshtatshëm për shtetasat vulnerabël. Ky kuadër ligjor kërkon që njësitë e vetëqeverisjes vendore të planifikojnë, zhvillojnë dhe zbatojnë programe të strehimit social, duke siguruar mbështetje të integruar social-ekonomike për qytetarët në nevojë. Si parim themelor i shtetit social, strehimi i përshtatshëm nuk është vetëm një politikë publike, por një e drejtë bazike e njeriut, e cila duhet të garantohet në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme nga autoritetet vendore.

Mosrespektimi i këtyre detyrimeve përbën cenim të drejtpërdrejtë të të drejtave dhe interesave legjitime të qytetarëve të grupeve vulnerabël, duke u mohuar atyre aksesin në një nga të drejtat sociale themelore: të drejtën për strehim të përshtatshëm dhe mbështetje sociale. Kjo situatë jo vetëm ngre shqetësime të natyrës juridike dhe institucionale, por edhe thekson domosdoshmërinë e ndërhyrjes urgjente të organeve përgjegjëse, në mënyrë që të garantohet zbatimi i parimit të shtetit social dhe detyrimi kushtetues për mbrojtjen e shtetasave në nevojë.

Sa më sipër, vlerësojmë se qasja ndaj familjeve/ individëve në nevojë dhe jo vetëm, që duhet të ketë bashkia si organ kyç i pushtetit vendor, për të garantuar mbrojtjen sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre duhet të jetë e tillë që marrja e shërbimeve publike të mos i mohohet asnjë qytetari, pavarësisht rrethanave të veçanta, duke respektuar dinjitetin njerëzor dhe parimet e shtetit të së drejtës.

Nga ana tjetër, procesi i shqyrtimit të kësaj çështjeje nga Avokati i Popullit është mbështetur vetëm në informacionin e përcjellë nga institucioni i DRSHTSH Fier, për shkak të mungesës së bashkëpunimit dhe refuzimit për të dhënë shpjegimet e kërkuara nga personat përgjegjës të Bashkisë Fier. Ky mosveprim përbën një shkelje të qartë të dispozitave ligjore dhe kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën e Avokatit të Popullit si një institucion kushtetues për të kërkuar informacione dhe shpjegime nga çdo organ i administratës publike, si dhe detyrimin e këtyre organeve për t’iu përgjigjur kërkesave të tij brenda kuadrit ligjor dhe kushtetues.

Në rrethanat e parashtruara më sipër, mosbashkëpunimi për dërgimin e informacionit të kërkuar nga Avokati i Popullit,⁵ përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Pra, parimi i bashkëpunimit në këtë rast është kushtetues dhe detyruar për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t’i

paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtime.

Rëndësia e këtij parimi konstatohet edhe në instrumentet ligjore që kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës publike apo funksionarët publikë¹⁴.

Duhet theksuar se Avokati i Popullit është institucion kushtetues, i cili ka rol “kontrollues” mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t’u krijojnë shanse të barabarta, të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike. Në këtë kuptim, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta, theksojmë se detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit gjatë hetimit administrativ, përveçse një detyrim i karakterit administrativ, është gjithashtu një detyrim Kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky institucion publik. Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Në vijim, theksojmë se mirëqeverisja, e cila afirmohet në mënyrë të veçantë nga Karta e të Drejtave Themelore e BE, duhet të konsiderohet si një koncept prioritar në veprimtarinë e përditshme të organeve publike. Rritja e standardit të shërbimeve publike të ofruara nga organet e administratës në cdo nivel është në qendër të politikave dhe angazhimeve të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Europian dhe përafrimit të legjislacionit tonë me Acquis Communautaire.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të përmbushjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të

¹⁴ Ligji nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, parashikon të drejtën e institucionit tonë për të kërkuar nga autoriteti kompetent, marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike apo nëpunësit e tyre, sanksionuar në nenin 22/1 të këtij ligji, në të cilin është parashikuar se: “Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”. Neni 63 pika 1, 2 dhe 3 e tij parashikojnë instrumente të tilla ligjore, në dispozicion të Avokatit të Popullit, si raportet vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut apo propozimi i masave ndaj nëpunësve përgjegjës.

drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”;

R E K O M A N D O N:

- *Marrjen e masave të menjëhershme për vlerësimin e mundësive për ofrimin e ndihmës sociale dhe mbështetjes për familjen B., për të përfituar nga programet sociale të strehimit që zbatohen nga Bashkia Fier, sipas nevojave të kësaj familjeje dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi.*
- *Evidendimin e përgjegjësive të stafit të Bashkisë Fier për mosbashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit, dhe marrjen e masave konkrete për të mos u përsëritur kjo situatë në të ardhmen.*

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj!

KOMISIONERE

Vilma SHURDHA

DV